



Viti i VII^{-të} i Botimit, Nr.2,
Dhjetor 2016

EKSPERTIMI SI PROVË DHE SIGURIMI I PROVËS NË PROCESIN CIVIL

Fatmir Tartale

Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Albanian University

Adresë kontakti: fatmirtartale@gmail.com

Përmbledhje

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të konflikteve, lind nevoja për të caktuar ekspertë. Ekspertët janë persona që kanë aftësi për t'u bërë organeve gjyqësore përshkrimin e saktë të një gjendjeje fakti me të gjitha hollësitë teknike të nevojshme, ose për t'u njoftuar këtyre organeve gjykimin e artit, të teknikës ose të shkencës mbi pasojat që rrjedhin nga një gjendje e caktuar e gjërave. Veprimi i ekspertëve quhet ekspertim, kështu që ekspertimi është mënyra me të cilën gjykata vlerëson njohuritë e posaçme të shkencës, të teknikës dhe të artit, nën hetimin e rrethanave të një konflikti gjyqësor. Ekspertimet janë të shumëllojshme sa janë dhe degët e shkencës, artit dhe teknikës. Më shpesh nga të gjitha, në praktikën gjyqësore përdoren disa lloje ekspertimesh, si: ekspertim mjekësor, ekspertim psikiatrik, ekspertim kimik, ekspertim teknik, ekspertim dokumentesh, ekspertim financiar, ekspertim ekonomik etj. Veç këtyre ekspertimeve të cituara më sipër, kryhen edhe ekspertime letrare ose artistike kur gjykata shqyrton një padi që ka për objekt të drejtën e autorit në një prodhim letrar, artistik ose muzikor.

Veç rëndësisë që ka caktimi i ekspertëve, për të kryer një ekspertim të caktuar, natyrisht që mendimi i shprehur prej tyre për zbulimin e evidentimin e një fakti që shërben për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar në konflikt gjyqësor, për ta përdorur atë si provë në procesin civil, një vend jo pak të rëndësishëm zë edhe sigurimi i provës, i cili bëhet kur prova nuk mund të merret në shqyrtimin gjyqësor nga gjykata kur të fillojë shqyrtimi gjyqësor i konfliktit gjyqësor në shqyrtim, pasi është ngritur padia civile përpara gjykatës kompetente në lëndë civile. Sigurimi i provës bëhet në rastet kur prova mund të mos merret më pas, pasi ajo mund të humbasë ose të vështirësohet përdorimi me efektivitetin e duhur i saj në procesin civil.

Fjalë çelës: *ekspertizë, civile, gjykatë, gjyqësor, çështje, ekspert.*

*EXPERTISE AS EVIDENCE AND THE PROVISION OF PROOF IN CIVIL PROCESS***Abstract**

Alongside the judicial review of conflict arises in determining the expert. Experts are people who have the skills to become judicial authorities for writing an exact fact situation with all the details necessary technical, or for these bodies were informed judgment of art, science or technique over the consequences that derive from a certain state of things. These experts are called expertise action. So expert is the way by which the court considers the special knowledge of science, technique and art, under investigation of the circumstances of a judicial conflict. The expertise are diverse as are branches of science, art and technique, often from all the case law are used several types of expertise such as expertise medical, expertise psychiatric expertise chemical, expertise technical expertise documents, expert analysis and financial expertise economic, etc. In addition to the above experiments are carried out literary or artistic expertise, the court considers a lawsuit to target for copyright in a literary production, artistic or musical.

Apart from the importance that has the assignment of experts to carry out an expertise of the particular course that the opinion I expressed them, for the discovery of evidence of a fact that serves to solve a particular issue in a judicial conflict, to use it as evidence in civil proceedings, a place not less important, voice and security of the test, which is done when evidence cannot be obtained, at the trial court, when to start judicial review of conflict court examined after the lawsuit was filed civil, before the competent court in civil cases. Providing test, carried out in cases where evidence may not post deals with, as it can be difficult to lose or effectiveness proper use thereof, the civil process.

Key words: *expertise, civil court, judicial affairs, expert.*

Ekspteri dhe eksptimi në procesin civil

Eksptimi kryhet nga persona që kanë njohuri të posaçme dhe kanë aftësi për t'i bërë gjykatës analizën e shqyrtimin e saktë të një gjendjeje fakti me të gjitha hollësitë teknike të nevojshme, ose për t'i njoftuar gjykatës gjykimin e tyre, duke u mbështetur gjithnjë në shkencën, teknikën, artin e mbi pasojat që rrjedhin nga gjendja e caktuar që eksptëve u është vënë përpara për të dhënë mendimin e tyre, nëpërmjet konkluzioneve që ai ka arritur. Thirrja e eksptit dhe caktimi i tij është në diskrecionin e gjykatës, por atë mund ta kërkojnë dhe palët, neni 225 i Kodit të Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë (1). Caktimi dhe kryerja e eksptimit është mënyra me të cilën gjykata vlerëson njohuritë e posaçme të eksptit në hetimin e rrethanave të një fakti ose të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen në gjykim që shqyrton. Eksptimet janë të shumëllojshme, por më shpesh në praktikën gjyqësore hasen këto eksptime: Eksptimi kontabël, ekonomik, teknik, i dokumenteve, mjekësor, psikiatrik, kimik ose letrar e artistik, kur gjykata shqyrton padi që ka për objekt të drejtën e autorit në një botim letrar, shkencor, muzikor, etj., sipas fushës që do të ketë lindur konflikti që shqyrtohet nga gjykata dhe që do të nevojitet mendimi i specializuar i eksptëve të fushës.

Në doktrinën procedurale ekzistojnë pikëpamje të ndryshme në lidhje me atë çka kuptohet me

ekspert dhe ekspertim në procesin civil, dhe veçanërisht këto tri pikëpamje: ekspertimi është vendim shkencor dhe eksperti gjyqtar shkencor; ekspertimi është një dëshmi shkencore dhe eksperti një dëshmitar shkencor; dhe pikëpamja se ekspertimi është një këqyrje shkencore ose këqyrja direkte.

Pikëpamja e parë se ekspertimi është një vendim gjyqësor shkencor dhe eksperti një gjyqtar shkencor, është në kundërshtim të hapur me parimin themelor procedural të bindjes së lirë të brendshme të gjyqtarit, sepse po të jetë eksperti, qoftë edhe me një rast të veçuar, gjyqtar shkencor, atëherë gjyqtari e humbet pavarësinë e tij në vendimin që do të japë, mbasi në këtë rast vendimi i gjyqtarit nuk do të jetë vendimi i dhënë prej tij, sipas bindjes së krijuar nga shqyrtimi provave në seancë gjyqësore, por do të ishte një vendim formal.

Pikëpamja e dytë që quan ekspertin si dëshmitar shkencor dhe ekspertimin si dëshmi shkencore është përsëri e diskutueshme sepse ka mendime që eksperti ngatërrohet me funksionin dhe natyrën e dëshmitarit dhe ekspertit, dhe nuk merr parasysh ndryshimet me rëndësi që ekzistojnë midis dëshmitarit dhe ekspertit, që janë, midis të tjerave, këto: dëshmitari i njofton gjykatës atë që ka parë dëgjuar etj., d. m. th. ai i njofton gjykatës fakte që kanë ngjarë dhe jo mendimet e veta mbi fakte; kurse eksperti, përkundrazi, nuk dëshmon mbi faktet, por ai i analizon faktet në prizmin e njohurive të posaçme duke shfaqur mendimet e tij mbi këto fakte. Por duke pasur në konsideratë doktrinën dhe praktikën ligjore në shume vende të botës, jam i mendimit se nuk mund të jetë kështu në çdo rast, pasi është e vërtetë që eksperti analizon ngjarje të kaluara, por kur eksperti kryen një ekspertim dhe konstaton se në një dokument të caktuar është ndërhyrë duke imituar shkrimin e një individi dhe nga analizat që bën, eksperti arrin në konstatimin e faktit se shkrimi nuk është i personit konkret, por është falsifikuar dhe pikërisht nga personi i paditur, atëherë ai konstaton një fakt dhe për këtë fakt është i vetmi dëshmitar që ka dijeni dhe ai, referuar dhe konceptit bashkëkohor të “dëshmisë së ekspertit”, do të dëshmojë si ekspert, por do të dëshmojë nën betim se thotë të vërtetën para gjykatës, për çka ai ka perceptuar drejtpërdrejt, të një fakti të caktuar, pra është dëshmitari i vetëm që provon ekzistencën e një fakti që ka lidhje me konfliktin në shqyrtim që ia kanë paraqitur gjykatës për ta shqyrtuar e vendosur.

Pikëpamja e tretë që e quan ekspertimin si një këqyrje shkencore ose një këqyrje direkte, nisat nga fakti se ekspertimi është vetëm një mjet në duart e gjyqtarit, që ngarkon ekspertët të kryejnë ekspertimin dhe gjatë kryerjes së tij ekspertit i duhet të kryejë dhe një lloj këqyrje direkte për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë në zgjidhje dhe në përgjigje të pyetjeve të shtruar nga gjykata, në vendimin e caktimit të tij si ekspert, për të kryer ekspertimin konkret, në sajë të aftësisë së tij të veçantë në atë fushë të dijes, shkencës, teknikës apo artit. Por kjo nuk është e vërtetë, se ekspertimi kryhet dhe pa bërë këqyrjen në vend, kur eksperti jep mendim vetëm në bazë të marrjes në dijeni të rrethanave të një çështjeje, duke i njoftuar gjykatës elementet shkencore të nevojshme, për të siguruar rrethana të caktuara. Por, edhe kur ekspertimi bëhet me këqyrjen e një sendi, këqyrje e bën eksperti dhe jo gjykata, kur ajo ia ngarkon ekspertit ekspertimin dhe brenda detyrës së tij është dhe këqyrja e sendit objekt ekspertimi sipas vendimit të marrë nga gjykata gjatë gjykimit, kur e ka caktuar ekspertin me këtë detyrë, për të sqaruar pyetjet e vëna në vendimin e marrë për marrjen e kësaj prove, gjatë gjykimit në procesin civil. Nga ana tjetër, edhe këqyrja që bëhet me ekspertim, është gjithmonë një mënyrë këqyrjesh fenomenesh të caktuara, me qëllim që në dritën e fakteve të tjera dhe të shkencës, të nxirren konkluzione të caktuara, dhe kështu këqyrja është vetëm njëri prej momenteve në kryerjen e ekspertimit dhe jo ekspertim vetë. Ekspertimi, siç u tha më sipër, është një mënyrë me të cilën gjykata vë në përdorim njohuri të posaçme shkencore dhe të tjera, në hetimin e rrethanave të një çështjeje.

Gjykata veç ekspertimeve që i dorëzohen nga palët, pa filluar shqyrtimi gjyqësor i provave, kryen

edhe vetë ekspertime me iniciativën e saj apo me kërkesë të palëve gjatë gjykimit. Gjykata këto ekspertime i bën për të plotësuar njohuritë e saj, kur për perceptimin ose vlerësimin e një prove që ka lidhje me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, janë të domosdoshme njohuri të posaçme, të cilat nuk i ka gjykata.

Me asnjërën nga këto pikëpamje nuk jam dakord, pasi nuk paraqesin atë çka është ekspertimi në të vërtetë në procesin civil, që është një nga provat që parashikohet nga Kreu XVI “Provat”, dhe në nenin 208 “Ekspertet”, është parashikuar si një prej provave nga ligjvënësi KPrC viti 1958 (2). Edhe në nenin 14 në kreun e III janë parashikuar “Provat”, e specifikisht në nenin 15 “Burimet e provave” në KPrC të vitit 1981 (3), ndër të tjera është parashikuar edhe mendimi i ekspertëve. Më së fundi, në Kreun e V të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë “Rregulla të Përgjithshme për provat”, gjykata me vendim lejon palët të provojnë faktet, mbi të cilat i bazojnë kërkimet dhe pretendimet e tyre, duke paraqitur ato prova që janë të domosdoshme e që kanë lidhje me çështjen e gjykimit”, neni 213 i KPrC i RSH në fuqi (4). Veç sa më sipër, edhe në Kreun e VI të K. Pr.C në fuqi “Eksperti dhe Ekspertimi” (5) është përcaktuar si një nga provat e parashikuara në atë ligj. Nisur nga kjo dispozitë procedurale, palët para gjykatës bashkë me padinë, mund të paraqesin mes provave të tjera edhe ekspertime që ata i bëjnë e i mbledhin pa u paraqitur padia, me kërkesat e tyre në ekspertë të fushës. Veç këtyre ekspertimeve paragjyqësore, të aplikuara shpesh në praktikën gjyqësore, sidomos për ekspertimin e dokumenteve teknike apo grafike, në gjykimet e pavlefshmërive të akteve, të përpiluara me kërkesë të palëve të kryera nga laboratorët shtetërorë apo ekspertë privatë të licencuar. Ekspertimi është një provë ndër provat e tjera që merren në shqyrtim nga gjykata dhe nevoja e kryerjes së tij është lënë në çmuarjen e gjykatës duke i cituar “. . Mendimi i ekspertit nuk është i detyrueshëm për gjykatën...”. Kështu është trajtuar në legjislacionin procedural civil shqiptar në përcaktimet që ka bërë ligjvënësi në nenin 208 të Kodit të Procedurës Civile të vitit 1958 (6), edhe në nenin 39 “Mendimi i ekspertit” i Kodit të Procedurës Civile të vitit 1981 (7), si dhe në nenin 224/a 224/b të Kodit të Procedurës Civile të Vitit 1995 (8), i cili është në fuqi, në të cilët mendimet e ekspertit apo i ekspertëve përbëjnë vetëm një këshillë për gjykatën dhe prandaj kjo nuk është aspak e detyruar që të pranojë këto mendime përveç kur e bindin. Vetëm se në rast të kundërt, kur ajo nuk e pranon mendimin e tyre e ka vetë mendim ndryshe, duhet të arsyetojë mospranimin e mendimit të ekspertit me vendim të marrë gjatë gjykimit ose me vendimin përfundimtar. Kjo kompetencë e gjykatës është e parashikuar nga të tre Kodet e Procedurës Civile, si ai i vitit 1958 (neni 208) (9), ai i vitit 1981 (neni 39) (10), dhe në Kodin e Procedurës Civile në fuqi (neni 224/b) (10). Emërimi i ekspertëve bëhet nga ana e gjykatës që shqyrton çështjen, pasi dëgjon edhe palët mbi personin e tyre. Ajo emëron një ose më shumë ekspertë. Duke urdhëruar kryerjen e ekspertimit, gjykata duhet të përcaktojë më qartë objektin e ekspertimit, d.m.th. të tregojë pikat ose rrethanat për të cilat ekspertët duhet të japin mendim.

Për përcaktimin e pikave ose rrethanave për të cilat kërkohet ekspertimi, gjykata duhet të dëgjojë mendimin e palëve dhe të prokurorit, në rast se ky merr pjesë në çështje referuar legjislacionit procedural civil të vitit 1958. Kështu, në Kapitullin VI të KPrC të vitit 1958, që në Kreun e VI “Pjesëmarrja e prokurorit në gjykim”, në Nenin 68 të tij parashikohet pjesëmarrja e prokurorit në gjykimin civil, që nga ngritja e padisë dhe marrja pjesë e tij në çdo fazë të gjykimit në një padi që është ngritur nga të tjerët, kur çmon së një gjë e tillë e lyp mbrojtja e interesave shtetërore, shoqërore ose e shtetasve. Veç rastit fakultativ, parashikohej dhe pjesëmarrja e tij në mënyrë obligative në gjykimin civil: “Prokurori detyrohet të marrë pjesë në gjykimin e një çështjeje, kur gjykata e çmon të nevojshme”. Kjo pjesëmarrje e prokurorit me vullnetin e tij apo me detyrim, i jep të drejtën atij si palë në proces të bëjë kërkesa ose protestë për vendimin e gjykatës, kur ai nuk është dakord. Pra trajtimi si palë në proces, ka qenë parashikuar në legjislacionin e vjetër procedural civil të vitit

1958, por edhe në Kreun e dytë të KPrC të vitit 1981, ku ishin parashikuar “Gjykata, Prokuroria, Zyra e ndihmës juridike, Përmbaruesi dhe Pjesëmarrësit e procesit civil” dhe në nenin 6 të tij ishte parashikuar njëri nga subjektet pjesëmarrës në procesin civil në gjykim; kjo pjesëmarrje ishte definuar si më poshtë: Prokuroria është organi që kontrollon zbatimin e përpiktë dhe të njëllojtë të ligjeve në procesin civil dhe ndërhyr që të mos veprohet në kundërshtim me ligjen. . ” (12). Sipas kësaj dispozite, prokurori, njëlloj si më parë, ngrinte padinë, kuadrin e kompetencave të mëdha nga ligjvënësi, ku dilte qartë se prokurori me fuqi të pakufizuara kontrollonte si në procedimin penal, edhe në procesin civil civile, për shkak të trajtimit të sistemit inkuizitor e regresiv si rrjedhojë e sistemit diktatorial, i veçantë në të gjithë botën, i cili kontrollonte nëpërmjet prokurorit procesin penal dhe atë civil. Referuar Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë në fuqi, ky subjekt, pra prokurori, nuk ka asnjë kompetencë në procesin civil në Shqipëri, pasi nuk merr pjesë në të, as me vullnetin e tij e as ngre dot padi në procesin civil, dhe as e ka në kompetencën e tij pjesëmarrjen në gjykim, referuar edhe legjislacioneve të vendeve evropiane, duke filluar nga Italia e me gjerë. Palët kanë të drejtë të parashtrajnë pyetje me shkrim (neni 211 K. P. C i vitit 1958) (13). Edhe në nenin 227 të Kodit të Procedurës Civile në fuqi, është parashikuar e drejta e palëve për të kërkuar sqarimin e çështjeve të caktuara mbështetur në kërkimet e këtij neni që parashikon: “Gjykata, pasi merr dhe mendimin e palëve, i cakton ekspertit çështjet për të cilat duhet të merret mendimi i tij” (14). Kur nuk pranon ndonjë pikë të propozuar nga palët në lidhje me ekspertimin, gjykata duhet të arsyetojë këtë mospranim. Me lejen e kryetarit, eksperti mund të marrë dijëni për rrethanat e çështjes, sqarimi i të cilave i nevojitet për të dhënë mendim. Eksperti mund t’u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të marrë pjesë në këqyrjen në vend dhe në shqyrtimin e provave sipas parashikimeve të nenit 211 K. P. C të vitit 1958. Edhe në nenin 227 të K. Pr. C në fuqi, është parashikuar e drejta e njohjes së materialeve të çështjes, marrja pjesë në seancë gjyqësore, të bëjë pyetje, etj. Po kështu, është parashikuar në këtë dispozitë edhe: “Kur sipas vendimit të gjykatës për kryerjen e ekspertimit, është e nevojshme që eksperti të njihet me sende, evidenca, llogari e dokumente të tjera, palët mund të jenë të pranishme dhe mund t’i paraqitin ekspertit me shkrim mendime, e vërejtje të specialisteve të tyre, të cilët mund të pyeten me cilësinë e dëshmitarit ose kërkesa që lidhen me plotësimin e detyrës, por gjithnjë brenda kompetencave të caktuara në vendimin e gjykatës”. Pra referuar kësaj dispozite procedurale, shohim së ekspertit i janë dhënë një gamë e tërë kompetencash për të kryer ekspertimin, ndër të tjera edhe paraqitja e mendimit të specialisteve që i kanë dhënë mendim me shkrim apo verbal në cilësinë si specialist të një fushe të caktuar që ata i ka angazhuar mbrojtja apo paditësi për të dhënë mendim shkencor, teknik apo artistik për çështje që kanë të bëjnë me objektin e konfliktit gjyqësor në shqyrtim nga gjykata. Përfshirja e gjithë këtyre kompetencave tregon përmirësimin në vijim të legjislacionit procedural civil, për realizimin e një procesi të rregullt ligjor nga gjykata civile. Natyrisht, ekspertët mund të japin mendim në fushën e tyre, por jo mendim juridik. Marrja e provës me anë të ekspertëve, është parashikuar edhe në nenin 213 të KPrC të vitit 1958 (15) dhe bëhet zakonisht para gjykatës, por kur sendi që duhet të këqyret nga ekspertët, nuk mund të sillët para gjykatës, ose kur marrja e provës me ekspertë do të haste në pengesa e vështirësi të mëdha, atëherë kjo marrje e provës nga eksperti mund të bëhet në vendin ku ndodhet sendi, duke pasqyruar ekspertin mendimin e tij me shkrim, ku duhet të paraqesë edhe vërejtjet apo kërkesat e palëve (neni 228 i KPrC në fuqi) (16). Eksperti që është i autorizuar për të ushtruar një profesion ose një mjeshtëri, dijenia e së cilës është kusht i domosdoshëm për një ekspertim, është i detyruar që të pranojë emërimin e tij, si ekspert. Në qoftë se një ekspert i emëruar, refuzon pa ndonjë shkak të arsyeshëm për të dhënë mendimin e tij, ose ndonjëse është thirrur rregullisht nuk shfaqet në seancën e caktuar pa ndonjë arsye të arsyeshme, dënohet me gjobë deri në 500 lekë dhe me sjelljen e tij përdhunisht si edhe dëshmitarët

(neni 106 K. P. C i vitit 1958). Në nenin 224/c të KPrC në fuqi është parashikuar se “Mosparaqitja e ekspertit në gjykatë, pa shkaqe të përligjura, shkakton sjelljen e tij me detyrim”. Ndërsa në nenin 165 të KPrC në fuqi është parashikuar: “Mosparaqitja në gjyq pa shkaqe të arsyeshme”, për mosparaqitje të dëshmitarit dhe ekspertit pa shkaqe të arsyeshme, kur është thirrur nga gjykata, ...” gjykata e dënon me gjobë deri në 30 000 lekë dhe urdhëron sjelljen e tij me detyrim” (18).

Inkompetenca e ekspertit të caktuar, në asnjë prej këtyre tre Kodeve të Procedurës Civile, nuk është parashikuar, se cila do të jetë zgjidhja ligjore që do të aplikohet nga gjykata dhe hapat që do të ndërmerren ajo para një pretendimi të tillë. Në caktimin e ekspertit, pasi i komunikohet vendimi i gjykatës, ai kur nuk është kompetent, për të kryer këtë ekspertim të caktuar me vendim gjyqësor, duhet t’ia paraqesë gjykatës inkompetencën e tij për të kryer këtë ekspertim dhe ajo, nëse e gjen pretendimin e kërkesën e paraqitur prej tij të drejtë dhe bindet se kërkesa e ekspertit është e drejtë, e zëvendëson atë duke caktuar një ekspert tjetër kompetent, për të kryer ekspertimin e kërkuar prej saj. Pra neni 225 i Kodit të Procedurës Penale në fuqi duhet plotësuar në paragrafin e dytë të tij, duke paraqitur në të se: “Eksperti që nuk pranon të kryejë këtë detyrë, me përjashtim të rasteve kur ekziston një nga shkaqet që e përjashtojnë atë nga qenia e tij ekspert ose kur pretendon se nuk është kompetent ose nuk ka mundësi të kryejë ekspertimin, duhet t’i njoftojë gjykatës argumentet përkatëse, të paktën pesë ditë përpara seancës gjyqësore” (19). Ky plotësim i dispozitës së sipërme, i jep zgjidhje ligjore mangësisë së konstatuar në dispozitat e parashikuara aktualisht, kur të kemi parasysh për parashikimin e ligjvënësit në nenin 225/2 “Mënyrën e Caktimit të Ekspertit” në Kodin e Procedurës Penale aktual.

Ekspertët mund të përjashtohen po për ato arsye për të cilat mund të përjashtohet një gjyqtar (d.m.th. për lidhje gjinie me një nga ndërgjyqësit, për interes që mund të ketë në çështjen në grindje, etj.) (neni 55 e 49 dhe 52, K. P. C të vitit 1958) (20). Por ndërgjyqësi që kërkon përjashtim, duhet të tregojë edhe arsyet e tij. Mbi përjashtimin vendos gjykata që shikon çështjen (neni 55/ II K. P. C të vitit 1958). Edhe në nenin 224/c të KPrC në fuqi është parashikuar përjashtimi i ekspertit nga pjesëmarrja e tij në gjykim, që bëhet kur janë kushtet e përcaktuara në nenin 72 të KPrC, në të cilin janë parashikuar “Rastet e përjashtimit të gjyqtarit” (21). Veç kësaj dispozite, edhe në nenin 225/3 të K.Pr.C në fuqi, është parashikuar rasti i veçantë, siç është: “për rrethana të dala rishtazi palët kërkojnë menjëherë përjashtimin e ekspertit, duke parashtruar argumentet përkatëse”. Natyrisht, do të vendosë gjykata për përjashtimin e tij nga ekspertimi i caktuar më parë, që ka në shqyrtim konfliktin gjyqësor, po me vendim të saj. Në qoftë së kërkimi i përjashtimit pranohet, emërohet menjëherë një ekspert tjetër, duke respektuar dispozitat për zgjedhjen dhe caktimin e ekspertit të ri, për të kryer ekspertimin, që ka vendosur më parë gjykata.

Eksperti, përpara së të kryejë ekspertimin, duhet të bëjë betimin, si ajo që bëjnë dëshmitarët nëse u paralajmëruan për sanksionet penale në rast refuzimi të kryerjes së detyrës për të cilën janë thirrur, ose që nuk shfaqin mendimin e tyre në pajtim të plotë me rrethanat e çështjes dhe me njohuritë e posaçme për të cilat është thirrur, apo për mendim të rremë, neni 209 K. P. C i vitit 1958. Edhe po t’i referohemi Kodeve të Procedurës Civile të mëpasme, atij të vitit 1981, është parashikuar në Kodin Penal si vepër penale e parashikuar nga neni 202 i Kodit Penal “Dëshmia, ekspertimi dhe përkthimi i rreme” (22), ndërsa në Kodin e Procedurës Civile në fuqi është parashikuar në nenin 224/c/1/2 të KPrC “Përgjegjësia e ekspertit”, dhe në nenin 309 të Kodit Penal “Ekspertimi i rreme” (24). Pra ligjvënësi shqiptar ka parashikuar përgjegjësinë penale dhe detyrimet civile, për detyrimin e ekspertit, për të shpërblyer dëmet që për faj të tij i janë shkaktuar palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në procesin civil, për të cilat përgjigjet eksperti i caktuar nga gjykata me vendim gjyqësor për të bërë ekspertimin, që ka pranuar detyrën, dhe ka kryer ekspertimin, të cilin

e ka dorëzuar në gjykatë në përfundim të tij.

Në lidhje me mendimin e ekspertit, referuar nenit 214 të KPrC të vitit 1958, parashikohet që mendimi i ekspertit jepet me gojë ose me shkrim, duke e lënë në çmim të gjykatës formën e paraqitjes së mendimit të ekspertit, që në të dy mënyrat e dhëna mendimi paraqitet në procesverbal dhe nënshkruhet nga eksperti dhe duhet të jete i arsyetuar. Në nenin 39 të KPrC të vitit 1981, që parashikon “Mendimin e ekspertit” dhe në nenin 224/c të KPrC në fuqi, parashikohet forma e paraqitjes së mendimit të ekspertit vetëm me shkrim, por duke lënë hapësirën që dëgjohet me gojë në seancë gjyqësore. Në seancë gjyqësore gjykata e palët i drejtojnë pyetje ekspertit për mendimin me shkrim të depozituar në gjykatë. Parashikimet afërsisht të njëjta të të dy kodeve të procedurës civile, krijon mundësi për zhvillimin e një procesi të drejtë gjyqësor, sepse mendimi me shkrim i ekspertëve, kur përfundohet nga eksperti, referuar edhe praktikës ligjore shumëvjeçare të gjykatave, i jep mundësi gjykatës në radhë të parë, por edhe palëve e pjesëmarrësve në procesin civil, të vihen në dijeni për mendimet e hartuara e paraqitura nga eksperti dhe të konsultohen me specialist të tjerë të fushës për mënyrën dhe konkluzionet e arritura prej ekspertit referuar atij mendimi me shkrim dhe të ndërtojnë secili pyetjet që do t’i drejtojnë ekspertit, për mendimet e paraqitura para gjykatës nga ai. Kështu kjo provë, si dhe provat e tjera të paraqitura në gjykatë, do t’i nënshtrohet shqyrtimit të saj në seancë gjyqësore dhe eksperti është i detyruar t’i përgjigjet pyetjeve të shtruara prej gjykatës, palëve e pjesëmarrësve në procesin civil, në lidhje me konkluzionet dhe mënyrën e arritjes së tyre. Mendimi i ekspertëve, siç cituam edhe më sipër, duhet të jetë gjithmonë i arsyetuar, domethënë se duhet të përmbajë jo vetëm konkluzionet, por edhe arsyetimin e këtyre konkluzioneve (neni 214 dhe i fundit i K. P. C i vitit 1958, neni 230/1 i KPrC në fuqi). Në qoftë se mendimi i dhënë nga ekspertët duket i metë ose i paqartë, ose ekspertët kanë dhënë mendime të ndryshme, gjykata kryesisht ose me kërkesë të palëve mund të kërkojë sqarime plotësuese ose të urdhërojë kryerjen e një ekspertimi të ri, duke thirrur ekspertë të tjerë (neni 210 K. P. C i vitit 1958 dhe neni 229 i KPr. C në fuqi) (25). Nga sa u përmend hollësisht, del së detyra e ekspertit është krejt personale dhe nuk mund t’i ngarkohet prej tij një personi tjetër. Por kjo nuk do të thotë që eksperti duhet t’i kryejë personalisht të gjitha veprimet e nevojshme për ekspertim, gjë që do të ishte e pamundur.

Prandaj është e nevojshme të bëhet një dallim midis ekspertimit dhe veprimeve përgatitore për ekspertim. Ekspertimi përfshin gjykimin teknik të dhënë mbi fakte të caktuara, kurse veprimet përgatitore janë veprime të ndryshme që bëhen për qëllim që të arrihet një mendim mbi faktet e caktuara. Gjykimin teknik e jep eksperti, kurse veprimet përgatitore mund t’i bëjnë edhe persona të tjerë ndihmës të ekspertit, por përgjegjësia për saktësinë e ekspertimit, sipas nenit 227 të KPrC në fuqi, i mbetet vetëm dhe vetëm ekspertit (26).

Ekspertët kanë të drejtë të kërkojnë nga ai që ka kryer ekspertimin, pagimin e shpenzimeve që kanë bërë dhe shpërblimin për punën e kryer, duke e paraqitur përpara gjykatës që e ka ngarkuar për të bërë ekspertimin dhe përlllogaritjen e materialeve të shpenzuara dhe të kohës, për kryerjen e ekspertimit të caktuar nga gjykata, për të vendosur ajo me vendimin e saj gjatë shqyrtimit gjyqësor apo në vendimin përfundimtar kur shprehet për themelin e çështjes në konflikt gjyqësor.

SIGURIMI I PROVËS

Në legjislacionet procedural civile të vitit, 1929, (neni 108), 1958 (Neni 220), të vitit 1981 (neni 20) dhe të vitit 1995 (292), sigurimi i provës, është parashikuar përafërsisht pothuajse në terma të përbashkëta.

Duke iu referuar së fundi nenit 292 të Kodit të Procedurës Civile në fuqi, është parashikuar se

kur sigurohet prova dhe ç'kuptojmë me sigurim prove: "Kur një provë, nga e cila varet zgjidhja e mosmarrëveshjes ose që ndikon në sqarimin e saj, ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet marrja e saj, me kërkesën e palës së interesuar, mund të urdhërohet marrja me përpara". Po kur dhe para kujt gjykate ngrihet e paraqitet kjo kërkesë para gjykatës sipas nenit 293 të K. Pr. Civile. Gjykata që shqyrton këtë kërkesë për sigurimin e provës, si kur është paraqitur padia, ashtu edhe kur nuk është ngritur ajo para gjykatës, është kompetente ajo gjykatë që investohet sipas kompetencës territoriale të përcaktuar në nenin 293 të KPrC në fuqi (27).

Provat, si rregull, merren zakonisht gjatë gjykimit, duke iu referuar të gjithë legjislativioneve procedurale civile në vitet d.m.th. pasi është ngritur një padi civile, por duke iu referuar fillimisht nenit 108, të Shtojcës së dytë të Kodit të Procedurës Civile të 2 Mars 1929, që ligjvënësi ka parashikuar se: "Ekzekutimi i një këqyrjeje ose dëgjimi i dëshmitarëve dhe i ekspertave me qëllim që të sigurohet provimi i një fakti, mund të kërkohe në çdo gjendje të gjyqit ose edhe para së të ngrehet padia, kur asht frikë se përndryshe mjete provues ka me humbë ose ka m'u vështirësuar përdorimi me efekt i atij mjete" (28), ajo mund të kërkohe edhe para se të ngrihet padia. Pra, duke nisur nga kryerja e një këqyrje direkte të një sendi ose dëgjimi i dëshmitarëve dhe i ekspertëve, mund të kërkohe edhe përpara se të ngrihet padia ose edhe pasi të jetë ngritur kjo, por para kohës së caktuar për paraqitjen e provës, kur bëhet me qëllim që të sigurohet provimi i një fakti me dëshmitarë ose ekspertë dhe është frikë se njëri ose tjetri prej këtyre provave, më vonë, kur do të duhet të paraqitet kjo provë, mund të humbasë ose të vështirësohet përdorimi me efekt i saj, kur kjo mund të ndodhë për çdo lloj shkak, sidomos për pyetjen e personave si dëshmitarë apo ekspertë, të cilët mund të largohen nga vendi, i rëndohet gjendja shëndetësore apo psikike për shkak sëmundjeje apo rëndimi të shëndetit, si dhe për këqyrjen e sendeve të caktuara, që gjendja e tyre ka rrezik të ndryshojë, për cilësinë për shkak të ndryshimit të kushteve të mbajtjes së sendit, e të pamundësisë së ruajtjes tij të pandryshuar, si në cilësi dhe në pamje, që ai në të ardhmen mund të pësojë ndryshime që cenojnë vërtetimin e një fakti të caktuar, që tashme është evident dhe i vlen palës që e kërkon këtë sigurim prove, sigurimi i provës duhet të bëhet domosdoshmërisht, që procesi civil të mbarëvejë sa më mirë. Kërkesa për provën paraqitet në gjykatën që shqyrton çështjen dhe në rast se padia nuk është ngritur, në gjykatën e vendit ku ka banimin personi që do të pyetet ose ku ndodhet sendi që duhet të këqyret. (Neni 293 i KPrC), po duke pasur në konsideratë atë çka parashikon neni 292 i KPrC, pra rrezikun e zhdukjes ose vështirësitë e marrjes së provës.

Pala e interesuar, sipas kërtimeve të neni 294 të Kodit të Procedurës Civile (29), në kërkesën për kërkimin e sigurimit të provës, duhet të tregojë: a) provën që kërkon të merret me sigurim prove, duke treguar emrat e dëshmitarëve që do të pyeten dhe të ekspertëve që mund të propozojë, sendin që do të këqyret, b) rrethanat për vërtetimin e të cilës shërben ajo, dhe c) arsyet që justifikojnë marrjen e saj më përpara, mbi kërkesën e tij. Prapë gjithçka kërkon dispozita, duhet të jetë e lidhur ngushtë duke parashtruar bindshëm domosdoshmërinë e arsytet që justifikojnë frikën se prova mund të zhduket ose të vështirësohet marrja e saj, e më së fundi d) të tregojë palën tjetër, të cilës duhet t'i komunikohet kopja e kërkesës, përveç kur kjo nuk dihet ose kur marrja e provës nuk lejon shtyrje. Nga ky detyrim i komunikimit të kërkesës mund të shkarkohet vetëm kur nga rrethana që parashtron, rezulton se nuk është në gjendje të tregojë palën tjetër, sepse nuk e di se kush do të jetë ose kur marrja e provës nuk lejon shtyrje. Fakti që ligjvënësi ka parashikuar njoftimin e palës tjetër kundërshtare në gjykim, tregon atë që kjo provë që kërkon të merret me sigurim prove edhe kur nuk është paraqitur kërkesë padia, do t'i nënshtrohet një shqyrtimi si ai i zakonshmi, ku do të marrin pjesë palët, do të paraqesë secila prej tyre pretendimet e veta në lidhje me këtë provë që duhet të sigurohet sipas kërkesës dhe pretendimet që ka pala kundërshtare për këtë kërkesë, si dhe shqyrtimi i kryqëzuar i saj nga palët në zbatim të parimit të kontradiktoritetit.

Mbi kërkesën e sigurimit të provës, të paraqitur nga pala e interesuar, vendos gjykata, duke marrë vendim për pranimin e kërkesës për sigurimin e provës, duke treguar në vendimin e saj provën që do të merret duke u shënuar dëshmitarët që do të pyeten dhe ekspertët apo sendin që do këqyret, etj., dhe mënyrën e marrjes së saj, neni 295 i KPrC. Marrja e kësaj prove nga gjykata nuk është detyrim për gjykatën kur gjykon themelin e padisë edhe në rastet kur ajo rrëzohet si kërkesë paraqitur gjykatës, referuar kërkesave të nenit 295 të KPrC, për të cilin në respektim të një procesi të rregullt ligjor, si ndaj çdo vendimi të marrë nga gjykata, lejohet të bëhet ankim i veçantë. Bashkohem me trajtimin që i bën doktrina, ku thuhet se: "...procedimi i sigurimit të provës, përfshin një farë gjykimi mbi rëndësinë dhe pranueshmërinë e saj..." (Procedura Civile, Alban Brati, Tiranë, 2008, f. 345-346) (30). Pra gjykata që do të gjykojë themelin e padisë së paraqitur referuar kërkesave të nenit 296/2 I të K. Pr. C, e cila ka përcaktuar se: "Për mënyrën e marrjes së provës dhe për fuqinë e saj provuese, zbatohen rregullat e përgjithshme" (31) që i jep të drejtën gjykatës që këtë provë ta marrë edhe me sigurim prove, e administruar në procesverbalin e seancës gjyqësore për sigurimin e provës, ajo do ta shqyrtoje atë, kur të vendosë lejimin e shqyrtimit të kësaj prove, në tërësinë e provave që paraqiten nga palët në shqyrtimin e padisë. Procesverbali i seancës gjyqësore që ka shqyrtuar e marrë një provë mbi kërkesën e sigurimit të provës, administrohet nga gjykata që e ka shqyrtuar atë. Në rast se padia ngrihet në një gjykatë tjetër, ky fashikull gjyqësor i dërgohet gjykatës që do të gjykojë çështjen. Ky fashikull që është krijuar si rezultat i sigurimit të provës mbi kërkesën e njëres palë, mund të përdoret nga secila prej tyre në gjykim, dhe nëse do të lindë nevoja për sqarime apo saktësime të tjera në lidhje me këtë provë, gjykata mund të vendosë si dhe për çdo prove tjetër, ta përsërisë marrjen e saj, në seancë gjyqësore. Nisur nga shpenzimet e mundshme që bëhen në rastet e shqyrtimit të kërkesës për sigurimin e provës, ato parapaguhet nga kërkuesi dhe në përfundim të gjykimit të themelit të kërkesë padisë së shqyrtuar nga gjykata, këto shpenzime të parapaguara nga kërkuesi, i ngarkohen palës, sipas rregullave të përgjithshme (neni 296 i KPrC) (32).

Referuar praktikës së organeve gjyqësore shqiptare, sigurimi i provës në procesin civil, pavarësisht edhe se ka një rëndësi të veçantë për gjykimin e padisë së paraqitur në gjykatë, nuk ka gjetur aplikim në procedimin civil, siç aplikohet në procedimin penal. Aplikimi i sigurimit të provës do të jepte një ndihmesë të rëndësishme, në raport edhe me provat e tjera që do të shqyrtojë gjykata, si të paraqitura nga kërkuesi, ashtu edhe ato të paraqitura nga pala kundërshtare në gjykim. Marrja e provës nëpërmjet kërkesës për sigurim prove, nuk është detyrues për gjykatën, pavarësisht se ky procedim për sigurimin e provës ka një pavarësi të përkohshme, nga gjykimi i zakonshëm i themelit të padisë së ngritur, për pranueshmërinë e provës, gjë e cila do të shqyrtohet kur gjykata të vendosë lejimin e marrjes së kësaj prove. Aplikimi i saj do të ndikonte pozitivisht në zhvillimin e një procesi civil më se të drejtë ligjor, por që siç duket, mendoj se do t'i mbetet të ardhmes, që palët, edhe nëpërmjet përfaqësuesve të tyre ligjorë, ta përdorin me efektivitet Kreun XI "Sigurimi i provës" të Kodit të Procedurës Civile, në funksion të vërtetimit sa më të mirë të pretendimeve të tyre të paraqitura në procesin civil para gjykatës civile kompetente.

REFERENCA

1. Kodi i Procedurës Civile, RSH, neni 225, Tiranë, 2015.
2. Kodi i Procedurës Civile, RPSH, neni 208, Tiranë, 1958.
3. Kodi i Procedurës Civile, RPSSH, neni 14, 15, Tiranë, 1982.
4. Kodi i Procedurës Civile, RSH, neni 213, Tiranë, 2015.
5. Kodi i Procedurës Civile i RSH, neni 225-231, Tiranë, 2015.

6. Kodi i Procedurës Civile, i RPSH, neni 208, Tiranë, 1958.
7. Kodi i Procedurës Civile, i RPSSH, neni 39, Tiranë, 1982.
8. Kodi i Procedurës Civile i R. SH, neni 224/a-224/b, Tiranë, 2015.
9. Kodi i Procedurës Civile, RPSH, neni 208, Tiranë, 1958.
10. Kodi i Procedurës Civile, RPSSH, neni 39, Tiranë, 1982.
11. Kodi i Procedurës Civile, RPSH, neni 68, Tiranë, 1958.
12. Kodi i Procedurës Civile, i RPSSH, neni 6, Tiranë, 1982.
13. Kodi i Procedurës Civile, RPSH, neni 211, Tiranë, 1958.
14. Kodi i Procedurës Civile, RPSH, neni 227, Tiranë, 2015.
15. Kodi i Procedurës Civile, RPSH, neni 113, Tiranë, 1958.
16. Kodi i Procedurës Civile, i RPSH, neni 228, Tiranë, 2015.
17. Kodi i Procedurës Civile, RPSH, neni 106, Tiranë, 1958.
18. Kodi i Procedurës Civile, RPSH, neni 165, 224, Tiranë, 2015.
19. Kodi i Procedurës Civile, RPSH, neni 225, Tiranë, 2015.
20. Kodi i Procedurës Civile, RPSH, neni 49, 52, 55, Tiranë, 1958.
21. Kodi i Procedurës Civile, i RPSH, neni 72, Tiranë, 2015.
22. Kodi Penal, RPSSH, neni 202, Tiranë, 1982.
23. Kodi i Procedurës Civile, RPSH, neni 224/ç/1/2, Tiranë, 2015.
24. Kodi Penal, RSH, neni 309, Tiranë, 2015.
25. Kodi i Procedurës Civile, RSH, neni 229, Tiranë, 2015.
26. Kodi i Procedurës Civile, RSH, neni 227, Tiranë, 2015.
27. Kodi i Procedurës Civile, RSH, neni 293, Tiranë, 2015.
28. Fletore Zyrtare 2 mars 1929 Nr, 24-bis Shtojcë e dytë e K. Pr. Civile, f. 384, Tiranë, 1929.
29. Kodi i Procedurës Civile, i RSH, neni 294, Tiranë, 2015.
30. Brati, Alban, Procedura Civile, faqe 345-346, Tiranë, 2008.
31. Kodi i Procedurës Civile, i RSH, neni 296/2, Tiranë, 2015.
32. Kodi i Procedurës Civile, i RSH, neni 296/3, Tiranë, 2015.